

**VENDIM**  
**Nr. 322, datë 2.6.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË  
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË  
PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**Tabelë**

| <b>Emërtesa e Bordit/<br/>Këshillit/Komisionit</b>                                                                                              | <b>Numri maksimal<br/>i pagesave në një<br/>vit</b> | <b>Përbërja</b> |                        | <b>Masa e shpërblimit<br/>në lek</b> |                |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-----------------|------------------------|--------------------------------------|----------------|
|                                                                                                                                                 |                                                     | <b>Kryetari</b> | <b>Nr. i anëtarëve</b> | <b>Kryetari</b>                      | <b>Anëtari</b> |
| Komisioni për Shqyrtimin e Masave Administrative të Marra nga Institucioni Përgjegjës për Kontrollin Zyrtar të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë | 12                                                  | 1               | 4                      | 10,000                               | 10,000         |
| Komisioni i Shqyrtimit të Masave Administrative të Marra nga Shërbimi Veterinar Shtetëror                                                       | 12                                                  | 1               | 4                      | 10,000                               | 10,000         |
| Komitetet sektoriale të kornizës shqiptare të kualifikimeve (10 komitete sektoriale)                                                            | 4                                                   | 1               | 9                      | 10,000                               | 10,000         |
| Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit                                                               | 6                                                   | 1               | 8                      | 15,000                               | 15,000         |